

Lazar Siliqi

8JA-1

557

re
Kargë
ENTUZIASTE

Gjermani

LLAZAR SILIQI

SH-1

557

14810
~~37878~~

BIBLIOTEKA E SHKUTIT
BUREKASTED

KANGË ENTUZIASTE

Vjersha

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1962

DËSHIRË

Si e vërteta vargun due të qartë,
si fjala nanë të afërt e të thjeshtë,
shpatull-granit, çdo peshë të randë me bartë,
të larmë e të begatë si e arta vjeshtë;

si shqipet të qëndrojë mbi kep të lartë,
zvarrisje të mos njohë në log të sheshtë,
vargun e due kushtrim, flamur, pankartë,
puhi që ledhaton, stuhi dhe heshtë;

natën të jetë pishtar dhe bukurezë,
ndër zemrat njerëzore dritë të ndezë,
me popull bashkë të rrojë, jo oshënar;

herë qetë të rrjedhë, herë vrullshëm si valomë,
vllazën në botë të gjejë, të ketë aromë
nga dheu ynë i moçëm shqipëtar.

MA I ZJARRTI HYMN

Me një krahnor nuk shprehet dashuniya,
me një shikim s'mund të përfshihet deti.
Gjithë ndjenjat që ndër zemra ngjall Partija
kush mund t'i derdhë n'kufijt e një soneti?

Partisë trimneshë i thurën kangë me mija,
veçse për ne Partija e Punës mbeti
vetë ma i zjarrti hymn, që ngre Shqipnija,
i kangve ma të bukura — poeti!

Ky dhé të lindi, populli t'ushqeu,
Tetori i Madh të priu në fitore,
me ty pamë dritë na bijt e këtij dheu,

për ty pa u tutë na bahemi therore,
njëzetvjeçarja ballëdlirtë, Parti,
nën marshet triumfale në stuhi!

BREZ MBAS BREZI

Shqipni...

Sa ndjenja zgjon tingllimi i kësaj fjale!

Ndër shekuj turrin kurrë s'e ndale!

Për ty, atdhe i moçëm edhe i ri.

tumat rrëfejnë,

ligjrojnë ngadhnjyeset male!

Ndër male lart, ku shqipet kanë folenë,

në qetësinë e monastireve

u ruejt ndër zemra

fama e ilirëve

e gjuha

e malli i zjarrtë për Skënderbenë.

S'më erdhi ndër vegime Skënderbeu

mbi gjokun krifëgjatë,

vështrim'n e tij të rreptë dalloj

ndër buste t'partizanëve heroj

e ndër herojt e gjallë të këtij dheu,

urtinë —

në burrat shqipëtarë dhe gratë.

Tash kali i Gjergjit

ma nuk çukërmon

t'zotin tue lypë me ngulm, —

të shpejtin at sot ka kush e shilon,

ka kush u prin aradheve

në sulm.

Hajrijet, Mujot e Halilat

orët e zanat s'i pajisin ma, —
 Partija
 vashat rrit si trandafilat,
 djelmoshave u jep fuqi të ra.
 Me dorë ata s'i çkulin lisat
 e ndër përleshje s'gjuhen me shkambij, —
 në ballë gjithnji
 me komunistat,
 kreshnikët, lidhë me besën e çelikët;
 dritë i dhurojnë atdheut.
 E ato fisnikët,
 që u gremisën thellë në hon,
 kundroj tue flakë të mykunat kanune,
 tue ngulë në parzëm dekorata pune,
 trimin tue zgjedhë
 si trimes i takon.
 Flamur të kuq
 kur përmbi torno ngul
 puntori i moçëm, trim me zemër djali,
 të gjallë shoh unë
 kreshnikun Dedë Gjo Lul,
 plakun e bardhë Ismail Qemali.
 Kur n'gjurma diversantësh
 të tërhuzët
 malsorët sulen nga çdo vend,
 ngjallen Selam Musatë
 e Tafil Buzët,
 nishan merr dorëshkathti Mehmet Shpend.
 Hije të zbehta në mesnatë
 s'më vinë
 të parët, që ende ndër varre rrinë
 ndër armë mbërthye, —
 ringjallë i shoh
 kah ruejnë sypishë kufinë,

hasmin burrisht kah kqyrin sy më sy.
Djaloshi,
që me çantë në shpinë ngjit malin
e «Zër'n e Popullit» çon tej në fshat,
më sjell përpara syve
ilegalin,
kur nga qyteti binte
atë melodi, që zemrat peshë i ngrinte:
ushtimën e të rreptit Stalingrad.
Në se ndojherë në fshat ke për të dalë ti,
hyn në shtëpitë, —
ngritë
jo me kashtë e baltë!
N'tryezë nuk ka ma venë ilire mjalti,
por t'ambël gjen kuvendin e ngadaltë
edhe rakinë t'ambël ta shtrojnë.
Në val't
e moteve që vinë
unë shoh Partinë
kah ngre la e më la flamur'n e saj.
Besën,
urtinë,
burrminë e bujarinë
na brez mbas brezi do të marrim pajë.

PRANË TË GJALLËVE

Erdh maji, mueji i buzëqeshjeve!
 Blerim... Fëmijë... Plane... Flamurë...
 Shqipni e punës, e përleshjeve,
 trokò kaluer!

Mes dritës, gazit e pekuleve
 ju shtat lëshoni, o fëmijë,
 se flejnë ndër varre midis luleve
 dëshmorë me mijë.

Tokës shkambore të stërgjyshave,
 që lenë e ranë me pallë në dorë,
 ju i faltë cicrimën e dallndyshave,
 o shokë dëshmorë!

Qirij s'ju ndezim si shenjtorëve,
 ndër zemra e sheshe lapidarë
 për ju naltojmë! Emni i dëshmorëve
 nuk ka të vdarë!

Betohemi na pranë muranave,
 na armët tueja ngrejme burrisht.
 Të ashprën dhimbë zemrat e nanave
 mbajnë krenarisht.

— Po ti, djalosh, që mbete maleve
a burgjeve të vranë me tmer,
ç'emën ke pasë?.. — Jehona e fjalëve
flutron mejherë:

— Unë emën s'kam. Kujtimin ruemëni!
Mbi rrasë — yll, drapën e çekan.
Në vend të emnit, vlezën, shkruemëni:
«Një partizan». —

Dëshmorë! Atdheun në rrjedhë të vjetëve
gjallnoni e ndritni rreze-diell,
udhën rrëfenani ju netëve
si yjtë në qiell!

Punës iu vumë, ia nisëm valleve,
se flakëm poshtë zinxhir e prangë.
Sot ju këndon pranë të gjallëve
ma t'hieshmen kangë:

KANGË DASHUNIJE PËR REPUBLIKËN

Me gjeth të vyshkët e me fjalë të ftohët
nuk ngjizet
poezija;
me këtë të lashtin dhé,
me gjelbërim të stinës s're,
me zjarr të zemrave vargu brumohet
dhe flakë e gjallë ai ndizet,
ndez shkëndija.
Nga dashuniya digju ti pishtar,
shpërthe me gjuhë të flakta,
që ligjërojnë frymzuese edhe të sakta
mu si t'isht'
zjarr olimpik që ndrit përjetësisht.
Në krahanor ti digju furrë,
që nxjerr vargjet-metale,
që kangë skalitin për të hjedhtat male
e për batake — kurrë,
që munden mbarë atdheun me e përtërthuer
me roje të çelikta,
që mund të bahen shpatë e pluer
e vegla të përpikta.
Çdo mbeturinë
e shpartallinë
e ardhmja po na fton:
me shembë e me qitë fare.
Mendimi i zyrtë të rrokulliset n'hon,

ndër mendje moti të shkëlqaret!
Dhe në se nata ne na sjell ndër mend
atë natën e përjetshme,
kur përmbi ne, o e shtrenjtë, që t'desha mbi
gjithkend,

bari do të lëkundet,
unë them: — Me vargje të shëndetshme
trishtimi i territ mundet.
Si hekuri në kudhë,
nën rrahjet e çekanit t'randë të jetës
njeriu kalitet e çan udhë,
i ngjitet
së përpjetës
burrnor, kushtues e përshëndetës.
E jeta grish: — Në gjitë e mi
ushqim, o njerëz, kini!
Në majë
të ngjitemi, të ngjitemi!
Në ajr të lirë vigaj të rritemi
me zemërat florini!
Borgjezi i knaqun
le të sodisë mbas buke
fityrën e vet të majme e verdhacuke
përmbi tryezë t'mermertë, —
na do këndojmë tryez'n e thjeshtë, të drujtë,
n'dy kupa alumini gjetht e blertë!
Na pranë e pranë sot do të rrimë në mensë
me këtë puntore faqekuqe e të përvujtë,
që n'dorë shtërngon si letër dashunije
një dispensë.
Në dashuni puntorja e re ka ra
me këtë fabrikë, që ngritëm si kala,
me këtë djalosh, që në repart ka ndeshë,
me t'ardhmen,

që na josh e buzëqesh,
me këtë të hieshmen,
të pathyeshmen Republikë.
që anmiq edhe kainë godet e fshik,
që kangës s'vet ia thotë pa frikë,
që edhe unë e due
si i etuni të cemtin krue,
si lundërtari të premtuemen tokë;
dhe ndjej se si më rrok,
sa herë sodis çdo pllambë të dheut shqiptar,
mahnitja
e leximeve të parë.

RRETH KËTIJ BREDH

Sonte rreth këtij bredh
vërshues e kambëshpejtë gëzimi bredh.
Rreth tij
Shqipnija përshëndet vitin e ri
mbas një vit lufte t'rreptë,
pune fisnike.
Në zemër të atdheut ngrihen n'ajri
pishat trupdrejta si mendime epike,
rojtare të agimeve fatlume.
Përmes mendimesh të ngatrrueme,
mes librash,
që të mykun mbetën,
nën shtylla e kupola të kishave
lëmoshë s'e lypëm të vërtetën,
por
vetë e zbuluem me armë shqiptare n'dorë
atje nën hije t'pishave,
kur n'vend të ulurimave të bishave
çeta këndonte marshin burrënor.

Mbaj mend si shkuem
në mbledhjen ilegale her'n e parë.
Në errësinë,
nga etja rreshkë edhe uritë,
Partija na dha dritë,
ujë edhe bukë më dha

e shpresa të mëdha,
zemrat kaliti si një farkëtar,
dhe e ndjeva vehten të pushtuem
nga romantika e fjalës
revolucionar.

Na s'duem një bardhësi artificiale,
na duem të pastrën borë
e ajr të lirë ndër male.
Me forcë të Gjergj Elez Alisë
të shkunden gatarinat shkëlqimrreme,
të nxirren dheut të vlerëshmet madame!

Sonte rreth këtij bredh
vërshues e kambëshpejtë gëzimi bredh,
të dytin hap
në pesvjeçar të tretë Shqipnija hedh.
Me andrrue dëshroj për ditët që vinë pas,
s'due të thërras
«bota u çmend!»
Unë emnat ma të dashun
due sonte t'i përmend.

VËRSNIK ME ATDHEUN E LIRË

Vështroni këtë djalosh!
S'ish ky,
që hasmin vu përposh,
që me të thatën misërnike mbi tryezë,
nga dashuniya ndezë,
u nis me shokë të ngrejë një shtet të ri...
Djaloshi leu bashkë me lirinë-kërthi,
për te
të tjerët
çanë nëpër stuhi.
Porse ky djalë,
që sonte aq preket për «Traviatën»,
me ndjenjat të lëmueta mndafsh,
si i ati,
n'asht nevoja,
e mund edhe shtërgatën,
si ai
di roje të qëndrojë gjithë natën,
di të urrejë,
të dashunojë me afsh.
Se bashkë me nanën, që atij i dha sisë,
me të shëndetshmen gjellë Partija e koi,
e farkëtoi
me flakën e trimnisë,
me zjarrin e pashueshëm të lirisë.
I riu ynë,

vërsnik me atdheun e lirë,
me ballë të gjanë,
të dliurë,
çdo së përpjete i ngjitet tash pa u ndalë,
në art tej flak çdo «izëm»,
me mall andrron të rrojë në komunizëm, —
e do të rrojë,
pa fjalë!
Djaloshi,
trimoshi atdheu im
vrapon ndër pesvjeçarë me kokën lart,
nandorin lavdiplotë ai pati start
dhe cak ai ka —
pranverën lule-e-gjelbërim.

14810
~~31818~~BIBLIOTEKA E SHKËTIT
SHKËRRI

KANGA E NATËS

Puhiza e natës —
mbi flokë të mi dorë ledhatare...
Llampat neoni —
purteka drite përmbi trotuare:
këtej
rruga të çon në lumtuni!
Po kanga e bulkut?..
Jo! —
Një za tinglues kitare!
Natë... Qetësi...
Pa lutje e pa pendim,
pa varre!

*

Ç'andrra më joshte nata si fëmi!
Me ballin xixillojash kunorue, —
mbret me kunorë
në ma fatbardhën mbretëni! —
mbas njani-tjetrit rrijshim tue vrapue,
tue cicëruë si zogj gazmorë...
Tue fishkëllue
seicili kthente në shtëpi të vet,
se çdo degë peme ngjante një shauret
e mbas çdo muri — kryet e një hajduti...

Fluturuën vitet,
 pema ma s'na tuti
 dhe një dëshirë vend n'zemër erdh tue zanë:
 përdhe
 përjetë
 bejlerë, frone e tiranë!
 Voglushi me kunorë mbret le të jetë!

*

Nata
 rrit hijet, dhimbjet, psherëtimat,
 nata ndjell prapësitë e tradhëtitë...
 Natën kobare
 nuk e druen kurrë trimat,
 që terrin e bajnë dritë!
 Nata këmishëzezë
 ka shue çdo bukurezë...
 Hidh sytë,
 vështro:
 vorrezë, vorrezë, vorrezë!..
 Breron,
 e egra rribë
 si me kamxhik rreh muret...
 Thellë në podrum të s'errëtës kolibë
 rradhitet me shpejti komunikata, —
 të vdekunit
 ngre nga qivuret,
 të gjallët
 hedh në sulm, —
 të davaritet nata!

*

Në mes të natës Dielli u lind.
Gjëmonin malet tej,
për bind
shkumzonte vala e detit:
Ishin dyqind,
vetëm dyqind
në natën e ilegalitetit!
Ishin dyqind,
vetëm dyqind,
s'duronin dot nën thembër!
Dyqind luftarë,
në duer — pishtarë,
trokisnin në çdo zemër!

*

Nete pa gjumë...
Jo nga takimi i parë i dashunisë,
që gjumin të grabit
në flatra të lumnisë;
jo nga fëmijë,
që qajnë e s'dinë se ç'kanë
dhe gjumë në sytë e prindëvet nuk lanë!
Nete pa gjumë,
ndër mbledhje tue buçitë;
nete pa gjumë
tinës tue kcyë avllitë;
nete pa gjumë,
tue ça rrethim e pritë;
nete pa gjumë,
pa strehë,
pa bukë,

pa dritë;
nete pa gjumë...
e pambarim të lumë!

*

Ç'lajme kumtoka nata?
Çka regjistron ajo me dorë të dridhunj?.
Djelmosha komunistë
me duerët lidhun,
fashistët tue goditë me fjalë si shpata,
qeli të lagshta
e uri për bukë,
beteja partizane,
barrikata,
për Front të Dytë premtime,
luftime në Tobruk,
nëndetse, aeroplanë edhe armata,
thirrje triumfi
dhe mandata...
Macja e përhimtë po mjaulit, —
vigani i kuq
nga lindja lëshon dritë!
Do të pushojë shtërgata!
Do fryjë i ambli fllad!
N'popuj
si orteku rritet zemërata,
gjëmojnë në botë:
Stalin
dhe Stalingrad!

*

E natës errësina ka zatetë.
 Dëgjo
 dhe fëshfërimën nëpër fletë,
 nuhat
 dhe aromën e një fije bari,
 shiko
 plagët në heshtje si i duron luftari!
 Zjarri
 me flakë të kuqe partizanët ndrit,
 nata burrnon ftyrat rinore,
 çdo hije-dritë
 të rijve u jep tipare kreshnikore...
 E cili dritëshkurtën do të thesh
 se ja
 këta çunakë,
 tue rrâ për tym e flakë, —
 t'pavdekshmit marathonomakë, —
 lirinë do sillnin midis nesh?

*

Sa më pëlqen në mes natyrës nata,
 kur ti
 me gjithësinë je vetëm, një për një!
 Vetëm me qenë
 me ata që s'janë në jetë
 e n'lufta ranë,
 që natë ma të mos ketë,
 kur zemrat e trishton ndamja e shkretë!
 Të atmes nanë
 me marrë uratën!
 Me heshtë
 e me mendue,

ndërgjegjen tande me hetue,
 për punë të mbara
 me premtue!
 Nata të fton për ditën me andrrue,
 për diell e vesë,
 zane rinore,
 nata të grish përjetësinë me rrokë...
 Kangës ia thoni, shokë,
 këndon horas
 në këtë natë gazmore!
 Dy netë,
 dy jetë! —
 Nata e parë e robënisë...
 Dhe ma e para natë me kangët e lirisë!

*

Në turn të natës. Punëtorët
 s'i tremben asnjë barre!
 Atdheut të ri
 ndër ara i duhen plorët?..
 Çfryn xixa gryka e furrës n'fonderi
 kah derdhet giza si ujvare, —
 për kremte
 ma të bukrat fishekzjarre!
 Çkarkojnë vaporet lidhë ndër skelet.
 Bilbilat pyjeve po dridhin gushën.
 Lëndinës grumbull kalojnë delet
 me sytë xixa fosfori.
 Armët në krah,
 fshatarët kqyrin fushën.
 Errsinën çpon me sytë vezllues traktorë.
 Me pushkë e pluer,
 me kangët ma të zjarrta në krahnuer,

drejt majes ma të lartë flutrojmë kaluer!
 Ndririt hana e qelibartë
 në natë të artë,
 kandshëm erzojnë
 lilat e trandafilat.
 Poetët, detet, malet e bilbilat
 kangët e tyne Diellit ia kushtojnë:
 Ishin dyqind,
 vetëm dyqind, —
 tash pesdhjetmijë luftarë!
 Në zjarr u lind, —
 ka yll e prind
 Partinë
 një popull mbarë!

*

Nata me terrin të kujton verbninë,
 që njuh vetëm një ngjyrë,
 që s'sheh as ma të dashunën fytyrë...
 Mendoj:
 ma zi asht për njerinë,
 që s'njuh t'shekullit tonë të kuqen flakë,
 që sheh me andje njerëzit përgjakë,
 që jetën çon
 në brrakë!..
 Gjumi i natës
 foshnjët rrit.
 Natën poetët thurën vargje-dritë.
 Kujtoj...
 Androjt...
 Flakë ndizem e buças:
 nata
 me shqotë
 kudo mbi botë
 agimin bie pas!

TRIUMF I KALTËR

Nuk vlen
kjo kaltërsi e qelqët.

Dy a tri re të bardha...
Një re e vrantë dyshimi...
Shtëllungë e zezë,
që zjen
nga zemërimi,
ngarkue me fshamje e lote...
Karvane të purpurta të një bote, —
të lumtunisë
lajmtare...
Një re e pafund — kubé e zyrtë gremisë...
Çamje e furishme resh me teha dritet,
triumf i kaltër,
brohori që rritet...

Të tillë
andrruj të kaltrin qiell,
të qetën e t'potertën kaltërsi.

S'andrruj një dashuni
me sy të kaltër e të ngrimë shenjtorësh,
me sy shitues qiellorësh,
një dashuni

si kaltërsija e qiellës,
që ngjan libër i bardhë e mospërfillës,
ku s'ka një fletë të shkrueme,
s'androj një dashuni
lëshue ndër krahët e zyrtisë...
Kërkoj
një dashuni të kaltër, të pashueme
mbi flatrat e stuhisë!

NUSJA PREJ DIVJAKE

Para veprës së A. Buzës

Të kishin vargjet ngjyrë!

Vargjet

kanë ritëm,

rimë...

Vetëm me to

nuk ka fytyrë,

portreti del

i zymët,

i përhimë.

Moj nusja e Divjakës,

jakë të rrimë,

zembrën hapja poetit!

Të zhytem due

në sytë e tu

si në thellsitë e detit...

Dhe deti fsheh

gjithë vuejtjet e breznive,

Dhe deti ndjell

gjithë andrrat e të rive.

Buzët,

shkrumue ndër shekuj,

buzët gjake

më flasin

me gjuhë flake

për shfrimin tand rinor,
o nuseja Divjake!

Faqet,
shekuj të zbeta,
ka nisë t'i puthë
trandafilija.

Bleron,
përtrihet jeta.
Ndër faqe t'nuseve
bulojnë çdo ditë

gonxhe të kuqe
mija.

Ndrit
horizonti i purpurtë
e qiell pa re
premtion.

Botën përçark
nën vetullat e zeza hark
me sytë si det

vështron,
moj nusja ime e urtë!
Sa e përvujtë
më ngjan...

Por nofullat shtërngue
përftojnë poterë.

Buzët e tua
dinë «të due» me thanë
vetëm një herë.

Ngjyrat e tua
tue këndue,

buzët e tua gjake,
m'u duk thue
erdha mik,
nuse Divjake,

KUR FLASIN SYTË

Ndër sytë e tu buron si dritë dashnija,
ani se goja hesht, kur flasin sytë.
Në mes të njerzve më pushton vetmija,
kur vetëm jam unë ndjehem vetë i dytë.

Por larg çdo brengë, vetmija të mërgohet, —
për sytë e tu kjo kangë le të buçasë,
që dashunija të qëndrojë e ngrohët
dhe kur dëborë mbi flokë na kem' me pasë.

Shikimi yt i ngultë, çdo përshëndetje
më nxit një varg të ri plot hir me nisë,
dy sytë e tu të pi më ftojnë me etje
në të përjetshmen gurrë të poezisë.

Pendën me zanë, me ndejë syçelë gjithë natën
më frymëzojnë dy sytë e tu të rrallë, —
veç ata sy mund të shpërthejnë shtërgatën,
në parzëm mund të derdhin zjarr e mall.

Qiellin vështroj ndër sytë e tu si shtrihet,
ndër qiej me u ngjitë na thrراسim shoqishojnë.
Dhe zemra ime meket a përtrihet,
kur sytë e tu trishtohen a shendojnë.

Kur qeshin sytë e tu — lulzon pranvera,
dhe pse e ambla stinë ende asht larg.
Nuk janë, jo, gjeth, që mbi asfalt mbledh era,
fjalët që hyjnë prej zemrës fill në varg.

Ndër sytë e tu unë shoh përpara detin
e larg andrrat e mija tue lundrue...
Ku shkojnë ato? Ku e çojnë ato poetin?
Drejt lumtunisë që rrjedh përjetë si krue?..

Dy sytë e tu më rikujtojnë sot mallin
e dashunisë së viteve të parë,
një botë të tanë dy sytë e tu më ngjallin,
dy sytë e tu të thellë e mendimtarë.

Për ty, e dashun, vargjet le të mbeten
si një kujtim që koha s'e venit.
Dy sytë e tu ndoshta kam pritë gjithë jetën,
ndaj kam në shpirt kaq ngrohtësi e dritë.

MBRAMË NË ANDËRR

Mbramë në andërr të kam pa gjithë natën,
mbramë në andërr unë jam shmallë me ty;
me ty pranë unë kam harrue krajatën,
mbi pullazin tonë që rri tue shfry.

Në një natë të tillë na për pranverën
andërruem së bashku plot me shpresë...
Vashë e rrallë, s'e di ku e ke derën,
para sysh m'u shkime porsi vesë!

Mbete ti e gjallë në zemrën time,
poezitë më le — të zjarrtat gjurmë...
Pa andrrime, ndamje e takime
jeta jonë do t'ishte krejt e murmë!

Gjithë ata që dashunue kurrë s'patën
e ndoherë në zemër mall s'kanë ndry,
s'do kuptojnë pse të kam pa gjithë natën,
mbramë në andërr pse jam shmallë me ty.

G J I T H M O N Ë

Kur kangë të re për ty filloj,
 ti det i fshehtë më ngjan,
 erë që lëmon e fshik njëlloj,
 ti etje ndez, flladit si kroi,
 je larg — e të kam pranë.

S'të due n'dritare si kërcunë
 tue fsha e tue lotue;
 dy kryengritës — ti dhe unë,
 dy zogj të lirë, që në furtunë
 thërrasin bashkë: — Të due!

Jo, dashuniya nuk asht pozë,
 s'asht lule në saksi,
 zambak s'të quej apo mimozë,
 çdo emën lulesh më ngjan prozë
 e ti je poezi!

S'të due as hanë, as yll të zbemë,
 kukull s'të due, as pronë,
 s'të due flori me dritë të rremë, —
 due flakë frymzimi të të kem
 gjithmonë, gjithmonë, gjithmonë!

M J E G U L L I N Ë

Ja rrezet shkrepën tej në kreshtë,
agimi shtriu mbi lum
t'purpurin kind.
Në vetmitarin zhur,
ku ngrihet pranë një urë,
ku rrapi lutet me të moçmet duer,
aty, buzë lumit, — thonë, —
nga trupi të mërgohen
përgjithmonë
magji
e xhind,
që strehë kanë t'egrën breshtë...

Ngroh dielli e ndrit,
por zemra e nanës
ngjethet.
Puhija foshnjes dot nuk ia flladit
faqet ndezë flakë nga ethet.
Fshatarja
foshnjen me cule e ka mbështjellë,
shërim
kërkon me dëshpërim,
dhe lumit ia ka sjellë.
— O lumi, që magjitë me vehte i merr,
ferishtes
sytë ti mos m'ia err!

O rrap, seli e t'ashprit kryexhind,
falma voglushin,
po të lus si prind!

Buçiti lumi me të vrullshmet valë
e rrap fletët tundi mengadalë...
Përmbi zhurishtë
la nana t'vetmin djalë.

Dita asht e gjatë,
sa e gjatë
e errta natë!—
një ditë edhe një natë mbi krye i rri
vocrrakut nana e mjerë.
Rrjedh lumi me poterë,
degët e rrapit —
krahë përbindshash n'erë.
Rrjedh lumi i trishtë, —
me erën
vdekja fryn përmbi zhurishtë.
Rënkon me lumin zemra e nanës,
por linë në zemër
shpresa përsëri.
Nën drit'n e zbehtë të hanës
qemeri i urës
hark mbi vorr të ri...

Synë dielli hapi nalt mbi kreshtë.
Faqja e vocrrakut —
gjeth i verdhë në vjeshtë.
Në zhur nuk u dëgjue
as gjamë,
as namë.
Në breg të lumit

nana
ngriu në kambë.
Ndër krahë voglushin mban shtërngue,
nga vdekja
kambët kruspullue,
në vend që të vraponte tue lodrue...
Dhe sheh tash nana nëpër tym:
ja korbat
mblidhen plym,
gjarpni dhe korbi po i mëkon fëmisë
e lumi rrjedh me valët çakërdisë...

Lumi këndon,
lumi ogurzi rrapllon,
lumi dhe mund të heshtë...

Të thrras unë due
për nanën, që s'bëzan,
të zhgul unë due të pamëshirtën heshtë
nga zemra jote, nanë!
Me davaritë due terrin,
bestytninë,
të helmtën mjegullinë!

GRUEJA ME BOHÇE NË DORË

Nusja asht ende e re,
prap gonxhe do shpërthejë nga afshi i dashunisë,
prapë sytë do t'i shkëlqejnë
nga flaka e ngrohtë e amësisë.
Nusja asht ende e re.
Por sot
dhjetë vjet u plak nga vula e zisë,
ndër sy —
pikllim i heshtun,
lot,
rreth syve — qark mavi,
në parzëm — zbrastësi...
Shtangue rri grueja
përpara derës së maternitetit,
lundër,
që pret hutue
nga do ta fryjnë dallgët e detit.
Në vend të vogëlushit
një bohçe ka në dorë, —
në bohçe veç pelena e ndriza, —
për gruen e re e randë por bohçja asht
sa rruzulli toksor!

Dy sy t'panjohun
gruen shporojnë si shtiza;
një vajë fëmije veshët ia shurdhon...

Andrron:

fëmija flen,

tenxherja gurguron,

e ajo

krrelat tue i përkëdhelë qëndron me orë...

Por jo.

zhduket vegimi e dita e re e gjen

fytyrë-irnue.

me zemrën krepatur,

me bohçen e mjerueshme plumb në dorë.

E pra,

kur vdiq,

vocrraku as emën s'kish ende.

Ende askush s'ka ndejë pa fjetë për te,

askush për te s'asht lodhë

në arë, minierë a shkollë.

Vetëm e ama e ka rritë

me gjak

të gjakut t'saj,

veç prindët foshnjen e kanë pritë

të çelë si trandafil në maj...

Vargjet

nga dhimbja e nanës s're

n'mendime bien e trishtohen,

në kambë prap çohen

tue vikatë:

— Jo,

shekulli i njëzetë,

shekulli ynë i rrallë,

të ardhmit shekull s'do t'i dalë përballë

me pjellën e dështueme në shami,

si grueja e gjorë,

që bohçen me pelena mban në dorë!

LUMUMBA!

Çupa nga kopështi u kthye tue qa:
 — Babà, përse Lumumbën e kanë vra?
 — Anmiqtë e ndoqën,
 e munduen,
 e shanë,
 në errësinë, moj bijë, e vranë!
 — Po çelë, babà, pse derën s'ia ke lanë?..

Lumumba, o vëlla,
 si t'i përgjigjem pafajnisë fminore,
 çupën si ta ngushlloj, që qan papra?..
 Ti mund të hysh
 pa trokëllue në derë a në dritore!
 Ti çupën eja me e pajtue!
 Në votrën tonë afrohu,
 ngrohu pak,
 fshij plagët la në gjak!..
 Lumumba,
 ti tash je i lirë!
 Si krahalehtët pllumba
 je i lirë!
 Shpata s'të pret,
 Lumumba,
 trupin s'ta bajnë dot shoshë me plumba,
 më kot xhelati sulet me kamxhik,
 roja ma s'çirret dot: mos ik! —

si shqipe je i lirë!
Ty ma s'të duhet pasaportë,
për ty, Patris, e hapun rri çdo portë.

Patris!

Me ty marshojnë të vdekunit e gjallë.
Afrika nanë
të mban ty yll në ballë.
Letra dërgon,
dhe e di se do të mbrijnë.
Vargjet që thure
si pishtarët ndrijnë
në burg, furtunë e terr,
Qymyr ti nxjerr
me minatorët tanë të Shqipënisë.
I heshtun rri ndër banka
të Universitetit të Miqsisë.
Nanat trimnon në varret e dëshmorëve.
Vështron i rreptë nga bustet e skulptorëve.
Me ne ti flet në qetësinë e netëve.
Me pllamb'n e zezë godet,
buçet,
për luftë thërret në vargjet e poetëve.

Eklips.

Natyra u lye me ngjyrë të mugët.
Me xhips
lugati rreh t'Afrikës rrugët.
Zemrën e Afrikës randë shkelmon
këpuca plumb me thumba.
Rënkon,
kushtron zemra njëlloj:
Lumumba!

Lugati etshon
Diellin me eklipsue,
nga goja i gurgullon inati e shkumba.
Në dhé e kallën, —
dheu rri tue gjëmue:
Lumu-Lumu-Lumumba!

E LIRË DO MBETET KUBA!

Tokën me gjak brumue, kangët e lira,
agim'n e artë me shkelë provuet, o cuba!..
Revolucioni s'lidhet në zinxhira!
S'asht çupë që shitet trotuaresh Kuba!

Korbat kobarë, mësue me u fâ me kërma,
mbi kokën tande, Kubë, vijnë tuba-tuba...
— Në kambë, o popull, vrik t'u jepet dërma! —
Fideli thrret. — Në kambë! — përgjigjet Kuba.

Nana kubane, kokën lart e ngrini
për bijët tuej, hiqni të zezat ruba!
Sheqeri yt, o Kubë, djeg si pelini!
Me gjak e hekur mbron fitoret Kuba!

Duerët në gjak përlye fsheh Uashingtoni,
si gjarpni i zi që struket ndër kaçuba...
Duerët t'ia presim! Popuj, zanin çoni:
— E lirë, e lirë, e lirë do mbetet Kuba!

NË KOZMOS NGRITËM YLLIN ME PESË
ÇIPA

E prisnim,
 si prindi pret foshnjen e parë.
 E di se do të vijë
 të mbushë me gaz shtëpinë,
 po kur
 foshnjen e ama mban në duer,
 zemra thue ndalet në krahnuer,
 nga lumtunija syu ndrin...
 Dhe lindi ai,
 jo një bir mbreti kordhëtar,
 po bir
 i komunizmit ngadhnjimtari.
 Shekujt që shkuen për ty andrruen qëkuri,
 bota u çmerit
 kur ma fort yjet vezulluen
 rreth teje,
 Juri,
 kur globin pe ti për të parën herë
 tue humbë në pafundsi
 dhe, si nga një majë mali në pranverë,
 thirre mahnitë:
 — Sa bukuri!

Blerimi i pranverës pa prenim
 me dymbëdhjetë,

në prill,
1961, —
këtë datë, o shekuj, e skalitni mirë! —
të grishi për të largtin fluturim:
— Rruga tash asht e lirë!
Në kozmos nisu fill! —
Dhe u nise ti,
pa hajmali,
në gji
«P.K.B.S.»,
veç katër shkronja.
I qetë u sule në përjetësi,
me synin e patrembun si shqiponja.
O popuj,
nipa dhe stërnipa,
të zjarrtin shekull prorë kujtoni.
na zgjedhë e perëndi
rrëzuem nga froni,
në kozmos ngritëm yllin me pesë çipa!

Ka tipa,
që në botë jetojnë qyqarë,
që midis njerzve
ndjehen vetmitarë...
Na jemi komunist, a,
komunarë,
trishtimi s'na ka hije,
qiellin sulmojmë të parë!
Rrethue vetmije
në kozmos tej,
në të pafundmit qiej,
ku s'ka as dritë as peshë,
na dijmë
me buzëqeshë!

Dy sy të kuq prej pijaniku
flakrojnë me smirë, —
anija-sputnik flet:

«Jam mirë!»

Bisha

me gojën çapëlye po lutet e gërthet:

«Nga qielli mos u ul!»

Dhe kambët prej paralitiku
i shkojnë sot shul-e-shul.

Dëgjoj

si natë e ditë vetvehten bren
imperializmi-hienë.

Grahma,

kërcnime,

grindje...

Buçet mbi rruzull: Lindje! Lindje! Lindje!

Imperializmit

kush të dojë

si macja t'i përqallet, —

na gjokset tona kem' debojë,

të madhin lajm çojmë gojë më gojë,

ndër sheshe hedhim vallet!

Përpara sysh, o kozmos, dilm'

si ma i mrekuullueshmi film!..

Ja Marsi,

Afërdita ja,

Mërkuri

po kuvendojnë me bir'n e Tokës Juri.

Shihni planetin tonë

në kaltërsi rrethue!..

Që kaltërsi të ketë mbi botë gjithmonë,

Juri Gagarin,

lajmtar të s'ardhmes ty të kemi çue!

MENDIME NË POLIGONIN E QITJES

Arma shkëlqen në dorë.
Toga —
në poligon.
Mirëmëngjes, ju male arbënorë!
Që dielli i lirisë
mbi ju të ndrisë
përorë,
ushtari i mirë me saktësi shënon.

Të gjitha — në të zezë...

Të zeza qenë
këmishat e fashistëve, —
kasollen tande, ushtar,
mbarë flakë e patën ndezë.
Të zeza —
zemrat e nazistëve,
që truëllin shqipëtar
me e ba patën andrrue
vorrezë.
Si natë e zezë
hija
e Kapitalit,
të errtën natë ai lyp si cubi malit.
Dhe pisë
e zezë —

fytyra e Tradhëtisë,
që edhe nanën shet, që na dha sisë.

Të gjitha në të zezë, sokolat e ushtrisë!

Të ziun anmik qëllo,
ushtar,
si trim i rrallë!
Ndero
yllin e kuq që ke mbi ballë!
I kuq —
flamuri i të parëve.
I kuq —
gjaku i burrave.
E kuqe —
shenja e proletarëve.
Të kuqe flakë n'uzinë —
grykat e furrave.
Buzët e vashës —
trandafil të kuqe.
Fëmijët, —
gazi ynë, —
të shndetshëm, faqekuqë porsi burbuqe.

Në poligon të qitjes —
toga trime.
Luftarët tue soditë, rashë ndër mendime...
Përqark kudo lulet erzojnë...
Pranverë...
E gjelbër si pranvera — rrobja e blerë!
Ballet djersitë
filladit e ambla erë.
O shok ushtar,
ven në shenjester ti

M
R
Q
E

çdo njollë të zezë, që strukë ndër zemra rri!

Arma shkëlqen në dorë.

Toga —

në poligon.

O, mirmëngjes, ju male arbënorë!

SHKAMB VIGAN

Në një gjyq tradhëtarësh

Krenare ngrë Shqipnija lart flamurët.
Kafshon Uollstriti prej zemrimit duerët,
përqark anmiqt tërbohen, hungrojnë t'urët
si ujë në dëborë.

Si ujë trathtarët hasmi i ndërseu, —
dora e Partisë për zverku i mbërtheu.
Kazmën ndërtuese mban gjithmonë atdheu,
pushkën shtërngon në dorë.

Dhe i vramë se ç'pamje kishte partizani,
sa i rreptë e madhështor zemër luani!
Po ju, trathtarë? Të mbrapshtë, të vdekun ngjani
edhe tue qenë të gjallë!

Jo, bij s'ju ka fisnikja nanë Shqipnija!
N'gjarpin ju shndroi i hueji, pabesija,
keqas fytyrat ju a shëmtoi trathhtija,
turpin ju vu në ballë!

Me thoj të duerve nanat na kanë rritun,
mbi t'lashtin truëll, me gjak e djersë vaditun,
me miq naltojmë godinën tonë të ndritun,
me e shembë që deshët ju!

Me zjarr e me sëpatë ju u vërsulët,
si cubat me ra pré, me zhgulun lulet...
Harruet, anmiq: — Ndër gjuj shqiptari s'ulet!
Ka zot ky vend këtu!

Nanës, që ju ka lindë, ju iu gërmushët,
kërkuet me i lanë jetima vogëlushët,
kupën, trathtarë, përplot me helm e mbushët,
atdheut ia shtritë me e pi!

Kupa u thërmue! Mbi ju do bjerë sëpata!
Në zjarr do digjen shpirtënt tuej si nata! —
Një shkamb vigan, që nuk e trand shtërgata,
janë popull e parti!

KANGË ENTUZIASTE

Fjalët nuk dalin fytin tue gërvishtë,
fjalët nuk janë gastare e brishtë,
që përdhe bie copë e grimë,
fjalët
nga krahanori i Republikës dalin
të lira, muskuloze, flakë e gjallë,
të shpejta vetëtimë,
fjalët
guxim ndër zemra shkojnë tue kallë,
fjalët mbi tokë marshojnë me hap t' sigurtë,
si shqipet kaptojnë malin,
fjalët e bajnë të ri plakun e urtë,
të urtë e të burruem ato e bajnë djalin.

*

Të ngriheshin të parët tanë,
rilindasit zemërzhuritun,
të ishin gjallë ata që ranë,
Shqipninë do e shihnin
zonjë
edhe të ditun!

Të ishin gjallë
ata që ranë...

Gjerdanin shokët trimit ia kanë lanë:
si na tregon gojdhani' e lashtë,
sa herë në luftë ta thrrasë
e shtrenjta nanë,
gjerdanin prap ai ngjesh,
varrit del jashtë.

Liri e shenjtë, o diell i ri, ndriçona!
Shqipnija asht e jona,
e jona!
Të zbathun, veshë e çveshë,
nën thirrjen e Partisë u ngritëm peshë,
atdheun e ri ndërtuem
me duerët tona.
Me thoj të duerve grryem na mineralet, —
për popull tash visare japin malet.
Në duert e veta
populli muer fatet,
me kilometra ma Shqipnija s'matet,
për ne tash flasin
kombinatet,
flasin për ne
puntorë e novatorë,
malsori i lashtë me abetar në dorë,
nana e dëshmorit urdhnat në krahnuer,
për ne
Partija flet —
i pastri
i pamposhtuni flamur!

Çfarë kobi ndillnin retë,
ç'mandatë?..
Fshatari i shkretë
me kafshët tok gdhinte t'pafundmen natë,

n'agim e priste kupa helm-e-vner
 dhe shtegu i malit çonte
 në humnerë...
 Dremiste jeta.
 Plogështi.
 Një shpend i egër ogurzi
 Shqipninë
 mbante shtërngue ndër kthetra t'veta.
 Kafshat'n e bukës dora e dridhun maste,
 bukë lypte foshnja në të mbramet çaste,
 Shqipninë
 stuhija pa mëshirë përplaste, —
 buçet nga parzmet tash
 kanga entuziaste!

*

Na para,
 veç përpara çamë,
 bishash rrethue n'çdo anë.
 Kënetat thamë, —
 të skuqej faqja e fëmisë.
 Vajza e ndryme veshi babë e nanë,
 endi pëlhurë,
 trimat që ruejnë kufinë, —
 kur ngrin kallkan, shtërgatat kur shpërthejnë, —
 të ndjejnë
 të duerëvet vashnore butësinë,
 të zemrave të reja ngrohtësinë.
 Të ngjatjetoj, o toka jonë e lirë,
 pa bej e hasëm!
 Parmendë e pushkë, vëlla, shtërngoji mirë!
 Një lufte s're ia hyne ti, —

sa mirë! —

me kmishë të bardhë e lule si në dasëm!

Me fjalë të zgjedhun po kërkoj
detal,

me të shumngjyrshmit gurë —
të mbush një mozaik...

Ma fort se vargu i shkathtë jambik,
se strofa ma e përsosun,
më flet

një shkollë e thjeshtë tutje atje në mal,
ai kufitar,
që anmikut i thotë: — Ndal!

Një anije e re që krenarisht çan detin,
një film i ri
a një premjerë baleti.

*

O diell, mirëmëngjez!

U ndez

përmbi vargmale qielli, —

seicili le t'ia hyjë punës së vet!

Ti me harë, o popull, përsëndet
ditën e re, —

i pesvjeçarit t'tretë ka nisun filli!

Ç'janë këto vasha e këta djelmosha?

Në çfarë beteje niset kjo brigadë?

Për ty,

atdhe i ringjallun,

prorë këndofsha!

Për ty, Shqipni, duhet këndue sot një baladë!

Brigadë...

Se ç'emën luftëtar!

Me zemrat zjarr

me zjarrin n'luftë naftarët se ç'janë ndeshë.

Si partizanë,
 me komandantë e komisarë,
 n'betëja të vërteta janë përleshë.
 Të reja — uzinat,
 njerzit — të rij këtu.
 Puntori
 pse sulmon,
 pse sulet ballë brigadës në repart
 e i duket puna jo mundim,
 po art? . .
 Atdheu i lirë kur lulëzon, —
 andrrën e tij të gjallë e shihni ju!
 I lumtun je, i lumtun,
 kur e di
 se jetën ven n'lëvizje edhe ti!

*

Metali pritët e hollohet,
 arë e djerrinë çan plugu.
 Kur vlugu
 i punës
 zien anëmbanë,
 robina e djeshme librin kur mban pranë,
 flamuret kur çpalosen n'qiejtë e gjanë,
 kur buza qesh,
 fikaten ohet.
 në çdo grafik shigjeta lart drejtohet.
 Këqyrni!
 Sheshevet,
 në çdo gazetë,
 në vatër të kulturës,
 në repart,
 porsi të rij atletë
 shigjetat kokën e ngrejnë lart!
 Me ballë krenar,

me synin sogjetar,
në shkall'n e tretë, popull shqiptar,
ven kambën me guxim!
Ngri harkun,
Pesvjeçar,
shigjetat lart të sulen fluturim!
Shigjetat lart! Shigjetat lart!
T'çirret anmiku, le të flasë përçart! —
Mban kokën tatëpjetë
shigjeta e tij...
Përpjetë
ka kohë që mban shtrigu i zi
veç top edhe raketë!
Shpërthejnë por zemrat si vullkan,
godasin fjalët si çekan:
— Në vig,
o popuj,
çdo tiran!
Në vig ju plakun shtrig! —
Shigjetat lart! Shigjetat lart!
Lart kanga!
Zemrat lart!
Me u ngrohë s'dëshrojmë na në shtrojër.
nuk duem, jo, dadë!
Partinë e Punës kemi timonier.
Dhe në çdo zemër,
çdo kantier
flamuri i kuq valon
porsi mbi barrikadë.

*

Kujtimet
sonte më vërshuen,

jo si relike nxjerrë nga fundi i arkës,
andrrimet më pushtuen,
jo andrra joshse fill mbas darkës
së bollëshme.

Kah unë,
krenarë naltue mbi bash të barkës
së ndritshme të kujtimeve,
sonte po vinë ata,
që në furtunë të luftës çlirimtare
nuk pyetën për uri, litar e prita,
që me pishtare
në qiell të natës shkruen:
Lirija! E vërteta! Drita!

Kah unë
me hap gazmor afrohen
ata që n'atmen tonë të lirë
në garë janë vu me kohën,
që zemërdlirë
Shqipninë stolisin me fisniken punë.
Argjent derdh hana mbi shtëpitë.
Vigaj të heshtun digat krijojnë dritë.
Oxhaqet e fabrikave të reja
në sfond të maleve të moçme
më kuvendojnë për vepra,
për beteja,
më frymëzojnë të hymnizoj lavdinë e soçme.

Punon atdheu me djersën ar në ballë,
në gjoks i vlon kanga ma e rrallë,
emnin pa mort t'Leninit ngre flamur,
por, ja,
në errësinë
për njerëzinë
prangat mizore gati mban ndër duer

përbindshi i egër shekulluer;
në terr
pëlhurën end shtriga intrigë,
me thimth të helmatosun porsi shlligë
sulet trathtija — farë e ligë.
Fara
nuk zen,
rranjë dot s'lëshon
në shkrepat tonë me gjak të lamë!
Për shqipet —
turp me u zvarrisë në hon!
Nder e lavdi —
prorë me qëndrue në kambë!
Njeriu nuk rron për pshesh e mëmëligë,
nga drita
lakuriqët veç kanë frigë,
s'duron Shqipnija turp edhe verigë,
për çdo vërshim
vullnetet tona t'zgjueme ngrejme na digë!
Brenga që zemrat ndrydhte e moliste
në kangë u shndrrue në tokën e Shqipnisë.
Për jetën tonë,
për t'ardhmen komuniste
na gjakun japim, kulmin e shtëpisë!

•

Natën unë sontë due ta hedh përtej,
të gjithve der n'agim due t'u rrëfej
se më ka lé fëmija i pestë,
në kopshtin tim —
lule e kërthnestë,
ambël dëshroj të pëshpëris...
Por filladi shndrrohet në stuhi,
që rreptas shkyen çdo tis!

Vargjet nuk duen lozhe të qeta,
porsi ushtarë rreshtohen ndër llogore.
Deri n'agim le t'rrahin si trumpeta,
që thrrasin për beteja
dhe fitore!

Me mija vjet jetojmë na në këtë truell,
Partija një agim të ri na suell.

Partija —

plaku i urtë në jetë vaditë,
djaloshi zemërzjarrtë e syskifter.

Partija —

shkamb, që then stuhitë.

Partija —

ma i pari brigadier,
flamuri ngadhnjimtari në çdo luftim,
nanë që s'mbyll sy në gaz e hidhërim.

Partija —

duerçelikti timonier.

Themelet mbrijtë — me gjakun e dëshmorëve.
Godina ngritë — me djersën e puntorëve.

Partija —

valavitja e flamorëve,

kanga e hareshë,

andrrimet e dashnorëve.

TRYEZA E LANDEËS

	Faqe
Dëshirë	3
Ma i zjarrti hymn	4
Brez mbas brezi	5
Pranë të gjallëve	8
Kangë dashunije për Republikën	10
Rreth këtij bredh	13
Vërsnik me atdheun e lirë	15
Kanga e natës	17
Triumf i kaltër	24
Nusja prej Divjake	26
Kur flasin sytë	29
Mbramë në andërr	31
Gjithmonë	32
Mjegullinë	33
Grueja me bohçe në dorë	36
Lumumba!	38
E lirë do mbetet Kuba!	41
Në kozmos ngritëm yllin me pesë çipa	42
Mendime në poligonin e qitjes	45
Shkamb vigan	48
Kangë entuziaste	50

JANE NE QARKULLIM

Letërsi artistike

Autorë shqiptarë

	Lekë
Naim Frashëri - Lulet e Verës (Vjersha)	15
Fan S. Noli - Historia e Skënderbeut.	30
Zef Serembe - Vjersha.	30
Gravil Dara (i riu) - Kënga e sprasme e Balës (Poemë)	20
Dh. S. Shuteriqi - Këngë	60
Hil Mosi - Zani i Atdheut (Vjersha)	70
Vedat Kokona - Me valët e Jetës (Roman)	60
Selman Vaqari - Artani (Dramë)	40
Zihni Sako - Njerëz dhe ngjarje (Tregime)	30
Jonuz Dini - Ditar pa data (Tregime)	35
Hasan Petrela - Të munduarit (Roman)	50
Spiro Çomora - Inzheksione që duhen bërë (Skeç)	20
R. T. Nepravishta - Pelikanët ndrojnë fole (Roman)	40
Nuçi Tira - Zbulime në shtrofkat e fundit të armikut (Kujtime)	35
Kin Dushi - Kronikë e vëndit tim. (Tregime dhe përshkrime)	30
Qemal Stafa - Qortimete vjeshtës (vjersha eskica)	20
Nexhat Hakiu - Fjala ime (Vjersha)	20
Ali Asllani - Shqipëria kryezonjë (Vjersha)	20
Nonda Bulka - Bota siç ish kur qante e qeshtë bilbili	45
Razi Brahimi - Katër vajza (Tregime)	35
Gjergj Zheji - Ngjarje në Çajup (Tregime)	25
Agim Cerga - Njeri i Zakonshëm (Tregime)	30
Gazmend Kongoli - Vajza me vath të kuq (Tregime)	25
Lec Shllaku - Artististi i popullit Zef Jubani	40